



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK



VENDIM

Nr.32, datë 10.11.2021

MBI

**“MIRATIMIN E RREGULLORES TË CIKLIT TË III TË STUDIMEVE, NË  
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjit Nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Universitetit të Arteve si dhe Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL, i ndryshuar, pasi diskutoi rreth draft rregullore përcjellë nga grupi i punës me Urdhër Rektori nr. 154, datë 29/10/2021 me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së Ciklit të III të studimeve, përcjellë nga grupi i punës, në Universitetin e Arteve të bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Prof. Arben LLOZI**

**Prof. Asoc. Dorian ÇENE**

**Prof. Asoc. Kastriot TUSHA**

**Prof. Endri SINA**

**Prof. Asoc. Albes FUSHA**

**Dea SHUBLEKA (Studente FAB)**

**Prof. Ilir MARTINI**

**Prof. Gazmend GJOKA**

**Prof. Dr. Erald BAKALLI**

**Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI**

**Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI**

**Sindi ZDRAVA (Studente FM)**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

Nr. 1440/1 prot.

Tiranë, më 08/11 /2021

Lënda: *Dërgimi nga grupi i punës i Draft-Rregullores së programit të studimeve të ciklit të III për fitimin e gradës shkencore Doktor, në Universitetin e Arteve*

Drejtuar: **Prof. Kastriot Çausi**  
**Rektor i UART**  
**Kryetar i Senatit Akademik të UART**





**Këtu**

I nderuar Prof. Çausi,

Në zbatim të Urdhrit me Nr. 152, datë 29/10/2021, Për “Ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores për ciklin e III të studimeve në Universitetin e Arteve” i Rektorit të UART Prof. Kastriot Çausi, po ju përcjellim bashkëlidhur kësaj shkrese, për miratim *Draft-Rregulloren e programit të studimeve të ciklit të III për fitimin e gradës shkencore Doktor, në Universitetin e Arteve*, të përgatitur nga Grupi i Punës.

Grupi i punës për hartimin e *Draft-Rregullores së programit të studimeve të ciklit të III për fitimin e gradës shkencore Doktor, në Universitetin e Arteve*

- Prof. Dr. Erald Bakalli
- Prof. Arian Paço
- Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj
- Prof. Asoc. Dorian Çene
- Znj. Suela Kromidha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE

**RREGULLORE**  
**E**  
**PROGRAMIT TË STUDIMEVE**  
**TË CIKLIT III**  
**PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE**  
**“DOKTOR”**  
**NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Miratuar me VSA Nr. 32, datë 10 / 11 / 2021







## Kreu I Dispozita të përgjithshme

### Neni 1 Baza Ligjore

Rregullorja e ciklit të tretë të studimeve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” ofruar pranë Njësive kryesore (Fakulteteve) të Universitetit të Arteve (UART), mbështetet në Ligjin Nr. 80, datë 22/07/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, VKM Nr. 112, datë 23. 02. 2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të Standarteve Shtetërore për fitimin e Titujve Akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar; UMASR Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL” VKM Nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar; VKM Nr. 75, datë 12.2.2018, “Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”; UMASR Nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë Nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor"; UMASR Nr. 29, datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”, UMASR Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të arsimit të lartë” i ndryshuar; UMASR Nr. 10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor"; Statutin e Universitetit të Arteve Tiranë, si dhe VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.

### Neni 2

#### Qëllimi dhe Objektivat e Programit të Studimit të Doktoratës

1. Programi i studimeve të Doktoratës që ofrohet nga njësia bazë (Departamenti), në Fakultetin përkatës në UART, është program i studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht





- akademik, i cili ka në bazë kërkimin shkencor, projektin artistik dhe veprimtarinë krijuese të pavarur në fushën e përcaktuar nga njësia bazë.
2. Programi i ciklit të tretë të Studimeve të Doktoratës ka për qëllim të formojë studiues të kualifikuar në fushën e muzikës/artit skenik/artit figurativ, të cilët do të kenë përgatitjen e duhur për t'ju përgjigjur kërkesave lidhur me zhvillimet artistike-kulturore në vend sikurse dhe bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar.
  3. Studentët e diplomuar do të kenë zhvilluar aftësi në hartimin dhe implementimin e projekteve kërkimore, studimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare, gjykimin bazuar në një këndvështrim kritik të zhvillimeve aktuale në artin shqiptar dhe më gjerë sikurse dhe kërkesave në rritje të tregut të punës sipas profilizimeve të ngushta të fushave kërkimore.
  4. Rregullorja e programit të studimit, përcakton misionin e studimeve, organizimin e brendshëm, mënyrën e funksionimit të programit si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve pjesëmarrëse, raportet midis tyre, vendos procedurat dhe kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit, për strukturimin e programit, rregullat e procesit mësimor dhe kërkimor për mbrojtjen e tezës si dhe parashikon sanksionet në rastin kur shkelet kjo Rregullore.

### **Neni 3**

#### **Ofrimi i programit**

1. Programi i studimit Doktoratë do të ofrohet në Universitetin e Arteve, pranë Fakultetit përkatës nga njësia bazë e këtij Fakulteti.
2. Përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programit të studimit të ciklit të tretë për fitim e gradës shkencore “Doktor” është Komisioni për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” i ngritur nga Fakulteti në të cilën do të ofrohet programi i studimit.
3. Në përfundim të studimeve, studenti fiton gradën shkencore “Doktor” në fushën përkatëse.

### **Neni 4**

#### **Përgjegjësitë e njësisë bazë pranë të cilës do të ofrohet programi i studimit “Doktoratë”**

1. Njësia bazë është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të Doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të Doktoratës.
2. Njësia bazë përcakton fushat e kërkimit, ku do të zhvillohen projektet e Doktoratës.
3. Njësia bazë shqyrton listën paraprake të kandidatëve fitues dhe ja përcjell Dekanit të Fakultetit për miratim.
4. Njësia bazë miraton, paraprakisht, udhëheqësit e punimeve të doktoratës.
5. Njësia bazë ka përgjegjësi të sigurojë studentëve doktorantë lehtësitë e nevojshme administrative për marrjen e informacionit dhe të literaturës së nevojshme kërkimore shkencore pranë institucioneve publike dhe private.







6. Njësia bazë ka përgjegjësi të garantojë përmbushjen e kriterëve formale nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.
7. Njësia bazë ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në raste kur konstaton probleme, propozon ndryshimet e nevojshme.
8. Njësia bazë ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e saj të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhet me procesin e fitimit të gradës shkencore.

## **Kreu II**

### **Organet Drejtuese, Komisionet dhe Stafit akademik**

#### **Neni 5**

#### **Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”**

1. Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, është Komision i përhershëm që ngrihet në nivel të njësisë kryesore sipas fushës së studimit në të cilën ofrohet programi i studimit. Ai është përgjegjës për monitorimin e të gjithë procesit të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.
2. Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” është përgjegjës për të vlerësuar dosjen e kandidatit, ngritjen e jurisë dhe për të marrë vendime për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
3. Detyrat e Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit Doktoratë

#### **Neni 6**

#### **Komisioni i Pranimit të dosjes së aplikantëve**

1. Komisioni i Pranimit të kandidatëve në studimet e doktoratës ngrihet nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë në të cilën do të ofrohet programi i studimit.
2. Komisioni i Pranimit përbëhet të paktën nga 3 anëtarë të Njësisë Bazë në të cilën do të ofrohet programi i studimit.
3. Dekani i Fakultetit në të cilën do të ofrohet programi përkatës, bazuar në propozimin e Përgjegjësit të Njësisë Bazë, emëron Kryetar të Komisionit të Pranimit një nga anëtarët e këtij komisioni.
4. Specifikimet e tjera në lidhje me Komisionin e pranimit të dosjes së aplikantit paraqiten në Rregulloren përkatëse të programit të studimit.

#### **Neni 7**

#### **Komisioni i Vlerësimeve të Pjeshme të ecurisë së programit**





1. Komisioni i Vlerësimeve të Pjesëshme (KVP) të Doktoratës përbëhet së paku nga 3 (tre) anëtarë.
2. Përgjegjësi i Njesisë Bazë propozon anëtarët e Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme të studimeve të Doktoratës, dhe ia përcjell për miratim Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
3. Anëtarët e KVP-së duhet të jenë specialistë të fushës dhe kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” të fituar në vendet e OECD ose ti përkasin kategorisë “Profesor”.
4. Të paktën një nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme, përjashtimisht rasteve kur mban gradën “Doktor” të fituar në një prej vendeve të OECD, duhet që përveç titujve akademikë Profesor dhe Profesor i Asociuar, të ketë edhe gradën shkencore “Doktor”. Në rastet kur pranë Njesisë Bazë nuk ka staf akademik që plotëson këtë kriter, atëherë pjesë e Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme mund të jetë një anëtar i një tjetër Njësie Bazë brenda Fakultetit ose një tjetër Fakulteti të UART, i cili përmbush kriteret sipas kësaj pike.
5. KVP-ja, mbledhet të paktën një herë në vit dhe shqyrton ecurinë e punës së doktorantit në Programin e Kërkimit Shkencor.
6. Bazuar në progres-raportin e Udhëheqësit Shkencor dhe Bashkudhëheqësit (nëse ka), sikurse dhe plotësimin e detyrimeve nga ana e doktorantit sipas planit të punës, dhe referimin e doktorantit, KVP-ja gjykon nëse doktoranti mund të vazhdojë ose jo programin e doktoratës në vitin pasardhës. Në rastin e përsëritur, më shumë se një herë, të mosplotësimit të rekomandimeve të KVP-së, ky i fundit mund të marrë vendim për çregjistrimin e kandidatit nga programi i doktoraturës dhe ja përcjell për vendimmarrje Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.
7. KVP-ja jep rekomandime për ecurinë e punës së doktorantit dhe vë në dijeni Komisionin e përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.

## Neni 8

### Juria e Mbrojtjes së Temës së Doktoratës

1. Juria e mbrojtjes së temës së doktoratës propozohet nga Njësia Bazë pranë së cilës do të ofrohet programi dhe miratohet nga Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.
2. Njësia Bazë propozon së paku 8 (tetë) anëtarë, të cilët, pas miratimit nga Dekani i Fakultetit, i përcillen Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
3. Juria e mbrojtjes së temës së doktoratës ngrihet nga Komisioni për dhënien e gradës "Doktor" dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët, të paktën 2 (dy) anëtarë të jashtëm i përkasin Njësive Bazë të fakulteteve të tjera të UART ose nga institucione homologe, vendase ose të huaja.
4. Anëtarët e Jurisë për Mbrojtjen e Gradës Shkencore “Doktor” duhet të kenë të paktën gradën shkencore “Doktor” të fituar në vendet e OECD ose ti përkasin stafit akademik të kategorisë “Profesor”.







5. Të paktën 2 nga anëtarët e Jurisë duhet të ketë gradën “Doktor” të fituar në vendet e OECD ose gradën “Doktor” dhe titujt akademikë Profesor ose Profesor i Asociuar.
6. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve i përket Njësive Bazë të fakulteteve të tjera të UART ose nga institucione homologe brenda ose jashtë vendit.

### **Neni 9**

#### **Udhëheqësi Shkencor**

1. Programi i studimit “Doktor”, do të zhvillohet nën drejtimin e Udhëheqësit Shkencor. Për raste të veçanta kandidati, ose Udhëheqësi Shkencor, mund të kërkojnë caktimin e një Bashkudhëheqësi.
2. Udhëheqësi Shkencor angazhohet nga Njësia Bazë e KMDP-së, bazuar në propozimin e kandidetit për doktorant dhe miratimin e Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.
3. Udhëheqësi Shkencor i Doktoratës është anëtar i stafit akademik të Njesisë Bazë pranë të cilës do të ofrohet programi i studimit, por mund të vijë edhe nga IAL të tjera, ose Qendra Kërkimore, brenda ose jashtë vendit.
4. Në rastet kur programi i doktoratës zhvillohet në bashkëpunim/bashkërisht me IAL të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, Kanadasë dhe SHBA-së, udhëheqësi mund të jetë pedagog i institucionit të huaj partner dhe të ketë të paktën gradën Doktor/PhD.
5. Specifikime të tjera në lidhje me Udhëheqësin Shkencor përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit “Doktoratë”

### **Neni 10**

#### **Detyrimet e Udhëheqësit Shkencor**

1. Udhëheqësi Shkencor ka detyrimin që të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave të udhëheqjes së punës kërkimore të doktoratës.
2. Ai duhet ti mundësojë kandidatin mbështetjen dhe këshillimin e duhur në përmbushjen e standarteve më të larta të realizimit të punës kërkimore brenda afateve të parashikuara.
3. Udhëheqësi Shkencor i doktoratës duhet të mbajë takime të rregullta me kandidatin për të konsultuar ecurinë e punës.
4. Në rastet e bashkë udhëheqjes, udhëheqësi dhe bashkudhëheqësi duhet të mbajnë kontakte të rregullta pasi të kenë rënë dakord për përgjegjësitë e secilit prej tyre.
5. Udhëheqësi Shkencor duhet të monitorojë dhe vlerësojë rregullisht progresin e studentit, bazuar në planin e punës së dorëzuar, përkundëjt standardit të kërkuar. Të vlerëdojë studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
6. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e referateve dhe publikimeve sipas planit të punës.





7. Të vërtetojë se, vërejtjet dhe rekomandimet e Jurisë, Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme, komisioneve *ad hoc* dhe Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”, lidhur me kërkimin janë trajtuar në mënyrën e duhur nga kandidati.
8. Të nxisë studentin që të botojë pjesë nga kërkimi i tij.
9. Udhëheqësi Shkencor duhet të hartojë progres-raportë rreth ecurisë së punës. Këto progres raporte duhet ti dorëzohen Koordinatorit, i cili ia përcjell Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme, bazuar në planin e punës së aprovuar dhe jo më vonë se përfundimi i çdo viti akademik.
10. Udhëheqësi Shkencor, në bashkëpunim me kandidatin për doktorant dhe, sipas rastit, Bashkudhëheqësin, hartojnë planin e punës së zhvillimit të doktoratës.

### Neni 11

#### Bashkudhëheqësi

1. Bashkudhëheqësi angazhohet nga Njësia Bazë pranë së cilës do të ofrohet programi i studimit, bazuar në propozimin e Udhëheqësit Shkencor dhe kandidatit për doktorant, pas miratimit të Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.
2. Bashkudhëheqësi është anëtar i stafit akademik të Njesisë Bazë pranë të cilës do të ofrohet programi i studimit, por mund të vijë edhe nga fakultetet e tjera në UART ose nga IAL të tjera, brenda dhe jashtë vendit.
3. Në rastet kur programi i doktoratës zhvillohet në bashkëpunim/bashkërisht me IAL të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, Kanadas dhe SHBA-së, bashkudhëheqësi mund të jetë pedagog i institucionit të huaj partner me gradën Doktor/PhD.
4. Në rastin e Bashkudhëheqësit që vjen nga një tjetër IAL ose Qendër Kërkimore, brenda ose jashtë vendit, nënshkruhet një memorandum bashkëpunimi mes UART dhe institucionit pranë të cilit është i angazhuar Bashkudhëheqësi.
5. Specifikime të tjera në lidhje me Bashkudhëheqësin Shkencor përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit “Doktoratë”

### Neni 12

#### Detyrimet e Bashkudhëheqësit

1. Bashkudhëheqësi ka detyrimin që të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave të udhëheqjes së punës kërkimore dhe realizimit të Temës së Dizertacionit.
2. Ai duhet ti mundësojë kandidatit mbështetjen dhe këshillimin e duhur në përmbushjen e standarteve më të larta të realizimit të kërkimit sipas parashikimeve të kontratës.
3. Bashkudhëheqësi duhet të mbajë takime me studentin dhe Udhëheqësin Shkencor për të konsultuar ecurinë e punës.
4. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e prezantimeve të ndryshme në konferenca, prezantime publike etj.







### Neni 13

#### Zëvendësimi i Udhëheqësit Shkencor dhe Bashkudhëheqësit

1. Zëvendësimi i Udhëheqësit Shkencor dhe Bashkudhëheqësit kryhet me vendim të Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”, pas miratimit të Njesisë Bazë pranë të cilës zhvillohet programi i studimeve të doktoratës.
2. Udhëheqësi Shkencor dhe Bashkudhëheqësi mund të zëvendësohen nëse përmbushet të paktën një nga kriteret e poshtëshënuara:
  - a. Dorëheqja e argumentuar Udhëheqësit Shkencor dhe/ose Bashkudhëheqësit.
  - b. Kërkesë e kandidatit, e argumentuar, për zëvendësim të Udhëheqësit Shkencor dhe/ose Bashkudhëheqësit.
  - c. Konstatim i konfliktit të interesit.
3. Procedurat e ndjekura për të gjitha rastet e parashikuara nga gërma a, b dhe c të këtij Neni, Pika 2, përcaktohen në kontratën e Udhëheqësit Shkencor, Bashkudhëheqësit dhe kandidatit për gradën shkencore “Doktor”.

### Neni 14

#### Koordinatori i programit të Doktoratës

1. Koordinatorin e programit të Doktoratës mbikëqyr zhvillimin e programit kërkimor të Doktoratës pranë Njesisë Bazë në të cilën do të ofrohet programi i studimit.
2. Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës shkencore Doktor, bazuar në propozimin e Njesisë Bazë, zgjedh me shumicë të thjeshtë, Koordinatorin e programit të Doktoratës i cili është staf akademik me kohë të plotë pranë Njesisë kryesore përkatëse.
3. Detyrimet dhe përgjegjësitë e Koordinatorit të Programit të Doktoratës specifikohen në Rregulloren përkatëse të programit të ciklit të tretë të studimeve ‘Doktoratë’

### Kreu III

#### Regjistrimi dhe Pranimi në Studimet e Doktoratës

### Neni 15

#### Njoftimi dhe Afatet në lidhje me pranimin në ciklin e tretë të studimeve

1. Njoftimi për shpalljen e konkursit për regjistrim në Programin e Studimit të Doktoratës shpallet me Urdhër të Rektorit të UART dhe publikohet në faqen Web të UART sikurse dhe në vendet e përcaktuara për lajmërimet pranë Njesisë kryesore në të cilën do të ofrohet programi i studimit.
2. Njësia bazë pranë së cilës do të ofrohet programi i studimit, duhet të përcaktojë kuotat e pranimi, kriteret e përzgjedhjes, tarifën e konkurrimit, tarifën e regjistrimit në ciklin e tretë të studimeve dhe tarifën e shkollimit të aplikantëve për studime në ciklin e tretë të studimeve në



Doktoraturë brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe tija përcjelli Dekanit të Fakultetit përkatës për miratim paraprak. Dekani i Fakultetit, kuotat e pranimit, kriteret e përzgjedhjes, tarifën e konkurrimit, tarifën e regjistrimit në ciklin e tretë të studimeve dhe tarifën e shkollimit, ja përcjell Senatit Akademik të UART për miratim.

3. Senati Akademik, pas miratimit paraprak të tarifës së regjistrimit dhe tarifës së shkollimit, në ciklin e tretë të studimeve, ja përcjell për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit të UART.
4. Fakulteti pranë të cilës do të ofrohet programi i studimit, ka detyrimin të bëjë publike kriteret e përcaktuara nga njësia bazë e tij, për fushën e kërkimit shkencor që ofron. Këto kritere nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.
5. Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimit në programin e studimit të doktoratës, publikohen në faqen zyrtare të UART, si dhe në ambientet e dukshme të Fakultetit të UART, të paktën një muaj përpara mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave.
6. Specifikime të tjera në lidhje me përmbajtjen e njoftimit për shpalljen e konkursit, përcaktohen në Rregulloren përkatëse të programit të studimit “Doktoratë”

#### **Neni 16**

#### **Regjistrimi në Konkursin e Pranimit**

1. Aplikimet në programin e studimeve të Doktoratës do të pranohen nga kandidatët që plotësojnë kriteret përkatëse të vendosura nga Njësia kryesore dhe Njësia bazë pranë të cilës do të ofrohet programi i studimit.
2. Specifikime të hollësishme në lidhje me regjistrimin në konkursin e pranimit përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit “Doktoratë”

#### **Neni 17**

#### **Konkursi i Pranimit**

1. Konkurrimi bëhet me dosje e cila duhet të përmbajë dokumentacionin sipas Shtojcës 1.
2. Vlerësimi maksimal i kandidatit është me 100 pikë. Minimumi i pikëve të grumbulluara për tu pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë “Doktor” përcaktohet nga Fakulteti përkatës.
3. Kandidati dosjen për konkursin e ciklit të tretë të studimeve e dorëzon në Sekretarinë mësimore të Fakultetit pranë së cilës do të ofrohet programi.
4. Sekretaria mësimore e Fakultetit e regjistron aplikantin në regjistrin e posaçëm të regjistrimit për konkurset e pranimit në ciklin e tretë të studimeve dhe i lëshon kandidatit një formular ku vërtetohet marrja në dorëzim e dosjes. Ky formular plotësohet në dy kopje. Formulari është bashkëlidhur kësaj rregulloreje tek shtojcat.
5. Njësia Bazë pranë së cilës do të ofrohet programi, ngre Komisionin e Pranimit i cili vlerëson me pikë elementët e dosjes së kandidatit. Dosja e kandidatit i dorëzohet Komisionit të Pranimit nga Sekretaria mësimore e Fakultetit përkatës.







6. Shpërndarja e pikëve për secilin nga elementët e dosjes përcaktohet nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë. Mbas vlerësimit të dosjeve të kandidatëve dhe renditjes së tyre me rend zbritës, Komisioni i Pranimit ia përcjell dosjen Dekanit i cili shpall fituesit dhe njofton Komisionin e përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor” me listën e kandidatëve fitues.
7. Lista e kandidatëve fitues shpallet edhe në faqen zyrtare të UARI si dhe në vendin e përcaktuar nga Fakulteti, gjithmonë duke respektuar kofidencialitetin e të dhënave të kandidatëve.

### **Neni 18**

#### **Kontrata e Doktorantit**

1. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë së Fakultetit pranë të cilës ofrohet programi i studimit “Doktoratë” sipas afateve kohore të shpallura.
2. Të gjithë kandidatët e shpallur fitues lidhin një kontratë me Njësinë Bazë pranë të cilës do të zhvillohet programi i doktoraturës, Udhëheqësin Artistik dhe Komisionin e përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”, ku specifikohen detyrimet e secilës palë.
3. Për tu regjistruar në programin e studimit të doktoratës, veç të tjerash, kandidati për doktorant, Udhëheqësi Shkencor, sipas rastit, Bashkudhëheqësi, duhet të paraqesin planin e punës i cili, pasi aprovohet nga Komisioni i Pranimit, formalisht, miratohet nga Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës “Doktor” dhe përfshihet në dosjen e kandidatit.

### **Kreu IV**


#### **Organizimi i Studimeve Dispozita të Përgjithshme**

Studimet e doktoraturës zhvillohen në përputhje me fushën e shpallur nga Njësia Bazë pranë së cilës do të ofrohet programi i studimit dhe organizohen në veprimtari kërkimore shkencore.

### **Neni 19**

#### **Kohëzgjatja e studimeve të Doktoraturës**

1. Studimet e doktoraturës zhvillohen me kohë të plotë, pranë Njesisë Bazë në të cilën do të ofrohet programi i studimit dhe kanë një kohëzgjatje normale jo më pak se 3 (tre) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike.
2. Në rastet kur kandidati për doktorant është i punësuar si personel akademik, me kohë të plotë ose të pjesshme, pranë një tjetër institucioni të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit Universitet ose Akademi, studimet mund të zhvillohen me kohë të zgjatur (5 vite akademike).





3. Në raste përjashtimore, me kërkesë të studentit, Komisioni mund të vendosë vetëm një herë për shtyrjen e studimeve të doktoratës, por jo më shumë se 2 (dy) vite në total. Arsyeja e shtyrjes së studimeve duhet të paraqitet e argumentuar nga kandidati.

### **Neni 20**

#### **Pezullimi i përkohshëm i studimeve**

1. Kandidati, për arsye të përligjura, ka të drejtë të pezullojë, në periudha të caktuara, për jo më shumë se 2 (dy) vite, studimet e doktoratës.
2. Me pezullimin e studimeve, atij i pezullohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me programin e tij të studimit. Këto i kthehen me rifillimin e studimeve.
3. Pezullimi i studimeve të doktoratës së kandidatit kryhet me pëlqimin e udhëheqësit dhe, sipas rastit, bashkudhëheqësit të cilët shprehen me shkresë drejtuar Njësisë Bazë pranë të cilës zhvillohet programi i doktoratës.
4. Kërkesa e kandidatit dhe mendimi i udhëheqësit dhe, sipas rastit, bashkudhëheqësit i përcillet Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.
5. Pezullimi i përkohshëm i studimeve të doktoratës mund të kërkohet duke filluar nga viti i dytë akademik dhe pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit të parë. Bëjnë përjashtim rastet kur kandidati kërkon të pezullojë studimet për arsye shëndetësore. Në raste të tilla kandidati nuk i nënshtrohet pikave 3, 4 të këtij Neni por është i detyruar ta vërtetojë kërkesën e tij me dokumentacionin lëshuar nga organet kompetente (raport mjekësor etj.).
6. Të gjitha arritjet dhe vlerësimet e kandidatit deri në momentin e pezullimit të studimeve merren parasysh. Në përfundim të studimeve ato përllogariten në funksion të përmbushjes së detyrimeve për mbrojtjen e Temës së Doktoratës.
7. Pezullimi i studimeve të Doktoratës, përjashtuar rastet e dokumentuara për arsye shëndetësore, mund të kërkohet vetëm 1 (një) herë, ndërkohë që afati i pezullimit nuk përllogaritet në afatet e kohëzgjatjes së studimeve të Doktoratës.

### **Neni 21**

#### **Ndërprerja e studimeve dhe çregjistrimi nga programi i Doktoratës**

1. Kandidati për titullin shkencor “Doktor” mund të largohet nga UART, duke u çregjistruar përfundimisht. Për këtë ai bën një kërkesë me shkrim pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit pranë të cilës ofrohet programi i studimit, në të cilën shpreh arsyet e largimit.
2. Çregjistrimi i kandidatit mund të kryhet vetëm pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet financiare të lindura deri në momentin e kërkesës për çregjistrim.
3. Dekani i Fakultetit të Muzikës urdhëron çregjistrimin e kandidatit dhe vë në dijeni Njësinë Bazë të KMDP-së dhe Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
4. Sekretaria Mësimore pasi kryen veprimet e çregjistrimit në regjistrin themeltar, ku vendos datën e çregjistrimit dhe nëse është e mundur firmën e studentit, vë në dijeni Sektorin Mësimor dhe të Kurikulave, Sektorin e Statistikës dhe Drejtorinë Ekonomike për këtë akt.





5. Kandidati i çregjistruar ka të drejtë të tërheqë dokumentet e tij.

### **Neni 22**

#### **Financimi i Studimeve**

1. Studimet e doktoratës, nuk financohen nga të ardhurat e Universitetit të Arteve.
2. Burimet Financiare për ndjekjen e studimeve të ciklit të tretë përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit “Doktoratë” që ofrohen pranë Fakultetit të UART.

### **Neni 23**

#### **Zhvillimi i studimeve të Doktoratës**

1. Studimet e doktoratës përmbajnë 180 ECTS dhe zhvillohen bazuar në Programin e Kërkimit Shkencor.
2. Programi i Kërkimit Shkencor zhvillohet nën drejtimin e Udhëheqësit Shkencor, në përputhje me planin e punës, fushën dhe projektin kërkimor. Fusha dhe projektet kërkimore përcaktohen nga Njësia Bazë, pranë të cilës zhvillohet programi i doktoratës, dhe publikohen së bashku me shpalljen e konkursit të doktoratës.
3. Programi i Kërkimit Shkencor strukturohet në:
  - a. Përmbajtjen Shkencore, e cila përfshin të gjithë veprimtarinë shkencore të kandidatit gjatë programit të doktoratës (konferenca, referate, publikime të ndryshme në revista etj.);
  - b. Tema e Dizertacionit.
4. Ecuria e punës shkencore të kandidatit do të vlerësohet çdo vit akademik, në përputhje me planin e punës së aprovuar, nga Komisioni i Vlerësimeve të Pjesëshme.
5. Në përfundim të vitit I akademik, kandidati paraqet projektin kërkimor të detajuar përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme. Në paraqitjen e detajuar të projektit kërkimor kandidati përqendrohet në:
  - a. Trajtimin e temës së kërkimit shkencor.
  - b. Bibliografinë e përzgjedhur dhe paraqitjen e disa rasteve konkrete në lidhje me temën e kërkimit shkencor;
  - c. Metodologjinë.
6. Në përfundim të çdo viti pasardhës akademik (viti II e në vazhdim) kandidati duhet të referojë përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme, rreth punimeve të kryera dhe ecurisë së punës kërkimore. Në referimet e pjesëshme kandidati përqendrohet në:
  - a. Adresimin e problematikave të verifikuara nga Komisioni i Vlerësimeve të Pjesëshme (nëse ka).
  - b. Ecurinë dhe rezultatet e punës kërkimore mbas referimit paraardhës.
7. Në përfundim të çdo viti akademik, kandidati duhet të raportojë tek Koordinatorin e Doktoratës rreth realizimit të Përmbajtjes Shkencore, sikurse dhe të dorëzojë dokumentacionin që vërteton realizimin e veprimtarive të Përmbajtjes Shkencore. Si rregull veprimtaritë e Përmbajtjes Shkencore duhet të shtrihen përgjatë të gjitha viteve të studimeve të doktoratës.





8. Përpara paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e Temës së Doktoratës, kandidati duhet:
  - a. Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-s, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
  - b. Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku, së paku, të jetë autor i dytë.
  - c. Të ketë paraqitur pjesë të punës kërkimore në të paktën 3 takime në kuadër të Forumit të Doktoraturës.
  - d. Të jetë vlerësuar pozitivisht nga KVP.
  - e. Të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare sipas kontratës së lidhur.

#### **Neni 24**

#### **Forumi i Doktoratës**

1. Forumi i Doktoraturës është një aktivitet i përvitshëm i mbajtur në kuadër të studimeve të doktoratës dhe i organizuar nga Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
2. Ai përbën një forum të hapur ku, kandidatët për doktorantë, trajtojnë dhe debatojnë me njëri-tjetrin tema të ndryshme sipas programeve të tyre kërkimore.
3. Forumi i Doktoratës organizohet nga Koordinatori i studimeve të Doktoratës dhe monitorohet nga Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës Doktor.
4. Rektori i UART, për çdo vit akademik, cakton një prej Koordinatorëve të programeve të doktoratës pranë Njësive Bazë, për të drejtuar dhe organizuar takimet e Forumit të Doktoratës.
5. Kandidati për gradën “Doktor” duhet të marrë pjesë të paktën 3 herë në Forumin e doktoraturës sipas afateve të përcaktuara prej tij dhe Udhëheqësit Shkencor.

#### **Neni 25**

#### **Ndryshimi dhe/ose Modifikimi i Temës së Doktoratës**

1. Kandidati ka të drejtën të ndryshojë dhe/ose modifikojë Temën e Doktoratës.
2. Ndryshimi dhe/ose modifikimi i temës së doktoratës së kandidatit kryhet me pëlqimin e Udhëheqësit Shkencor dhe, për rastet kur aplikohet, të Bashkudhëheqësit, të cilët shprehen me shikresë drejtuar Njësive Bazë pranë të cilës zhvillohet programi i doktoratës.
3. Përgjegjësi i Njësive Bazë, brenda 5 ditësh, i përcjell kërkesën Komisionit të Vlerësimeve të Pjesshme i cili, brenda 5 ditësh, jep vendimin e tij.







4. E drejta për ndryshimin dhe/ose modifikimin e Temës së Doktoratës mund të ushtrohet vetëm një herë dhe jo më vonë se përfundimi i Semestrit të parë të vitit I akademik referuar fillimit të studimeve të doktoraturës së kandidatit.

## Neni 26

### Doktoraturat Ndërinstitucionale

1. UART gëzon të drejtën e organizimit të studimeve të doktoraturës në bashkëpunim me IAL dhe Qendra Kërkimore të tjera brenda dhe jashtë vendit.
2. Në rastet e doktoraturave të përbashkëta, mes institucioneve nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi ku përcaktohen detyrimet e secilës palë dhe institucioni përgjegjës për monitorimin e studimeve.
3. Marrëveshja e nënshkruar, përveç të tjerave, duhet të marrë parasysh:
  - a. Përcaktimin e institucionit përgjegjës për monitorimin e studimeve të doktoraturës.
  - b. Përcaktimin e institucionit përgjegjës si partneri kryesor në nënshkrimin e diplomës “Doktor” sipas emërimit përkatës.
  - c. Caktimin e dy udhëheqësve.
  - d. Njohjen reciproke të gradës shkencore “Doktor” sipas emërimit përkatës.
  - e. Gjuhën e hartimit të Temës së Dizertacionit.
4. Në rastet e parashikuara sipas përcaktimeve të Nenit 11 (Bashkudhëheqësi), një nga udhëheqësit, mund të përmbushë edhe detyrat e Bashkudhëheqësit Akademik.
5. Në përfundim të studimeve të doktoratës ndërinstitucionale, diploma shkencore “Doktor“, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar, lëshohet si diplomë e përbashkët, e dyfishtë ose e shumëfishtë dhe nënshkruhet nga të dy institucionet partnere.
6. Programet e doktoratave ndërinstitucionale mund të parashikojnë rregulla të tjera dhe/ose të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë rregullore.

## Kreu V


### Tema e Dizertacionit dhe Mbrojtja Dispozita të Përgjithshme

Pranimi në mbrojtjen e temës së dizertacionit, nis sapo kandidati paraqet kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm për të filluar procedurën e mbrojtjes së temës së dizertacionit.

## Neni 27

### Dizertacioni

1. Tema e dizertacionit konsiston në një punim shkencor origjinal.





2. Dizertacioni duhet të respektojë kërkesat e paraqitjes sipas këtij neni. Nëse dizertacioni nuk paraqitet sipas këtyre kërkesave, ai nuk pranohet deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.
3. Në rastin e doktoratuave ndërinstitucionale, sipas përcaktimeve të Kreut IV, Neni 26, mund të aplikohen standarte të ndryshme të paraqitjes së dizertacionit të cilat duhet të jenë përcaktuar në marrëveshje mes palëve partnere.
4. Të paktën 5 (pesë) kopje të Dizertacionit duhet të dorëzohen në origjinal.
5. Dizertacioni ka një shtrirje rreth 200-250 faqe (pa llogaritur figura, citime, shembuj muzikorë ose jo dhe tabela me numëruesin e tyre). Ai formatohet si më poshtë vijon:
  - a. Koperlina formatohet sipas Shtojcës 2 ku lart në qendër duhet të vendoset logoja e UARIT dhe Fakultetit pranë të cilës do të ofrohet programi i studimit. Në qendër më poshtë vendoset emërtimi i programit. Në mes të faqes, në qendër vendoset titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i Udhëheqësit dhe, kur ka, Bashkudhëheqësit dhe viti i mbrojtjes;
  - b. Faqja e parë duhet të përmbajë: Përmbledhjen e temës (abstraktin) në shqip dhe në anglisht. Secili nga variantet duhet të shtjellohet në jo më shumë se 200 fjalë në Times New Roman 10;
  - c. Fushën dhe fjalët kyçe në shqip dhe në anglisht;
  - d. Dizertacioni duhet të shtypet në letër të bardhë të cilësisë së lartë në format A4 dhe të lidhet;
  - e. Materiali shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Dorëshkrimet nuk pranohen;
  - f. Teksti duhet të shtypet në Times New Roman 12, me hapësirë 1.5 mes rreshtave. Tabelat e gjata shtypen në hapësirë 1. Shënimet, citimet dhe bibliografia shkruhen në Times New Roman 10;
  - g. Hapësirat (marginat) duhet të jenë:
    - g.1. Hapësira e sipërme 1”
    - g.2. Hapësira e poshtme 1”
    - g.3. Hapësira e djathtë 1.25”
    - g.4. Hapësira e majtë 1.25”
  - h. Numrat e faqeve vendosen poshtë dhe në qendër të faqes;
  - i. Parathënia shkruhet me shkronja kursive; Hyrja numërohet me shifra romake ndërsa pjesa tjetër e punimit me numra arabë. Faqet e bibliografisë dhe shtojcave të ndryshme numërtohen me numra arabë në vijim të tekstit;
  - j. Shënimet (footnote) duhen vendosur në fund të faqes përkatëse dhe jo në fund të punimit.
  - k. Tabelat numërtohen (me numra arabë) dhe vendosen në trup të punimit e jo në fund. Fjala “Tabelë”, numri i Tabelës dhe legjenda e saj vendosen në krye të Tabelës. Kur Tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse Tabela përmban citate, duhen shënuar referencat;
  - l. Kur punimi përmban diagrame dhe figura, ato duhen vendosur në faqen përkatëse. Ato numërtohen me numra arabë dhe shpjegimet vendosen poshtë tyre. Nëse një diagramë kalon në faqen pasardhëse ndiqet rregulli i përcaktuar për Tabelat;







- m. Ku punimi përmban materiale shoqëruese (CD, video etj.) që janë pjesë e rëndësishme e punimit, ato i bashkëngjiten atij dhe shënohen te Tryeza e lëndës që vendoset në fillim të punimit;
- n. Bibliografia e plotë vendoset në fund të punimit.
- o. Përdorimi i ideve apo edhe i një pjese të punës së të tjerëve duhet të evidentohet në tekst duke bërë shënimin në listën e referencave ose në bibliografi.
- p. Për të gjitha citimet nga burimet e të tjerëve duhet të shënohet qartë burimi.
- q. Sqarimet e mundshme të kandidatit duhet të futen në kllapa katrore.
- r. Nëse burimi origjinal mungon por ai është gjendur në një burim të dytë, atëherë duhet të citohet edhe burimi i parë edhe burimi i dytë.

### Neni 28

#### Pranimi në Mbrojtjen e Doktoratës

1. Për tu pranuar në Mbrojtjen e Temës së Doktoratës, kandidati dorëzon pranë Dekanit të Fakultetit ku do të ofrohet programi i studimit:
  - a. Temën e Dizertacionit të përfunduar (në pesë kopje).
  - b. Një përmbledhje të dizertacionit (në tre kopje) me rreth 2000-4000 fjalë në gjuhën shqipe dhe në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht dhe spanjisht).
2. Specifikat në lidhje me përmbajtjen e dosjes shoqëruese, si dhe afatet kohore duke filluar me kërkesën me shkrim për mbrojtjen e diplomës dhe deri në përcaktimin e datës për mbrojtjen e saj nga Juria e mbrojtjes, përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit “Doktoratë”

### Neni 29

#### Etika e punës kërkimore

1. Kur dorëzon tezën e përfunduar studenti duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij.
2. Kandidati nuk lejohet të paraqesë si punim të ri një temë të nisur më herët që e ka paraqitur ose nisur në kuadër të shkollës doktrale në një institucion tjetër. Doktoranti mund të paraqesë pjesë të punës së tij, duke treguar qartë se cila pjesë e punës është përdorur edhe më parë.
3. Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe të fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse. Duhet të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren ide të të tjerëve.
4. Kandidati duhet të sqarohet nga Udhëheqësi i tij që në fillim të punës, për rrezikun dhe pasojat në rastet e konstatimit të mashtrimit, falsifikimit dhe të plagjiaturës.

### Neni 30

#### Mbrojtja e Temës dhe Fitimi i Titullit Shkencor “Doktor”





1. Mbrojtja kryhet e hapur për publikun me përjashtim të rasteve kur, për arsye të veçanta (të dhëna konfidenciale, sekret profesional etj.), me vendim të Dekanit zhvillohet vetëm në prani të Jurisë.
2. Në rastet kur, për arsye të përligjura, anëtarë të Jurisë, nuk mund të jenë të pranishëm në datën e shpallur, mbrojtja e temës së dizertacionit shtyhet dhe Juria cakton një datë tjetër. Ri caktimi i datës së mbrojtjes, për shkak të pamundësisë së pjesëmarrjes së një prej anëtarëve të Jurisë, përveç Udhëheqësit, mund të bëhet vetëm një herë. Në të gjitha rastet e tjera veprohet sipas përcaktimeve të Pikës 3 të këtij Neni.
3. Nëse ndonjë prej anëtarëve të Jurisë tërhiqet nga pjesëmarrja, ose kërkon shtyrjen e datës së mbrojtjes për më shumë se një herë, Komisioni për dhënien e gradës shkencore "Doktor" cakton, prej anëtarëve të propozuar nga Njësia Bazë dhe të miratuar nga Dekani i Fakultetit pranë të cilës ofrohet programi, një tjetër anëtar.
4. Për arsye të përligjura, kandidati ka të drejtën të kërkojë shtyrjen e datës së mbrojtjes dhe caktimin e një date tjetër.
5. Specifikime të hollësishme në lidhje me anën procedurale të mbrojtjes së temës së disertacionit si dhe vlerësimi i doktorantit përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit "Doktoratë"
6. Në përfundim të të gjithë procedurës së mbrojtjes së doktoraturës, Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia përcjell Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore "Doktor".
7. Në rastet kur vlerësimi i Jurisë është **50% e më shumë e pikëve totale të mundshme**, Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës shkencore "Doktor", brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin për dhënien e gradës shkencore "Doktor" sipas emërimit përkatës dhe ia përcjell Dekanit.
8. Dosja e kandidatit, përfshirë tezën e dizertacionit, vlerësimin e Jurisë dhe vendimin e Komisionit të përhershëm për Dhënien e Gradës shkencore "Doktor" i përcillet Rektorit të Universitetit të Arteve.
9. Diploma për Gradën "Doktor" nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit të Arteve. Një kopje dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për tu pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.
10. Kandidati, dizertacioni i të cilit konsiderohet **pakalueshëm**, ka të drejtë të ri paraqesë, pranë Komisionit për dhënien e Gradës "Doktor", temën e doktoratës së rishikuar me një afat kohor jo më herët se 6 (gjashtë) muaj dhe jo më vonë se 1 (një) vit nga vlerësimi i Jurisë. Paraqitja e temës së dizertacionit mund të përsëritet vetëm një herë.
11. Për të gjitha rastet e parashikuara në pikën 13 të këtij Neni, Juria brenda 15 ditësh nga data e ridorëzimit të temës së dizertacionit, ricakton datën e mbrojtjes e cila nuk mund të jetë më vonë se 3 (tre) muaj nga data e ridorëzimit të temës.
12. Nëse edhe në mbrojtjen e dytë kandidati merr vlerësimin **49% e më pak të pikëve totale**, Komisioni për dhënien e Gradës shkencore "Doktor" merr vendimin për regjistrimin e kandidatit nga programi doktoratës dhe vë në dijeni Njësinë Bazë, pranë të cilës zhvillohet programi i doktoratës, dhe Dekanin e Fakultetit përkatës.





13. Kohëzgjatja e procedurave të mbrojtjes apo rimbrotjes së temës së doktoratës, nuk llogariten brenda kohëzgjatjes (normale apo maksimale) të studimeve të doktoratës.

### **Neni 31**

#### **Publikimi i Temës së Dizertacionit**

1. Doktoranti ka të drejtën e publikimit të Temës së Dizertacionit vetëm mbas vlerësimit përfundimtar pozitiv të Jurisë.
2. Doktoranti ka për detyrim që: një kopje të temës së Dizertacionit duhet ta dorëzojë në Bibliotekën e Universitetit të Arteve dhe një kopje në Bibliotekën Kombëtare. Fletën e dorëzimit të kopjeve të dizertacionit i dorëzon pranë sekretarisë së Fakultetit përkatës në të cilën ofrohet programi i studimit.
3. Në rast të mos dorëzimit të këtyre fletëve, Doktoranti nuk pajiset me diplomë.

### **Neni 32**

#### **Revokimi/anulimi i Gradës Doktor**

1. Nëse pas mbrojtjes së dizertacionit ka të dhëna të besueshme, konstatohet apo vërtetohet se grada shkencore ‘Doktor’ është fituar në shkelje të rregullave të etikës mbi kërkimin shkencor, ose kur mbrojtja është bërë në kundërshtim me kuadrin ligjor, fillon procedura për anulimin e kësaj grade. Procedurat e këtij anulimi përcaktohen nga njësia kryesore.
2. Personi ndaj të cilit fillon procesi i shqyrtimit të gradës, duhet të njoftohet në lidhje me shkakun, procedurat që do të ndiqen dhe mbi të drejtën që ka për t’u mbrojtur, në përputhje me Kodin e procedurave Administrative.

### **Neni 33**

#### **Apelimi**

1. Kandidatët të cilët nuk fitojnë të drejtën për tu regjistruar në programin e studimit të doktoraturës, kanë të drejtën që, brenda 5 ditësh pune nga shpallja e rezultatit, të paraqesin ankimin e tyre me shkrim pranë Dekanit të Fakultetit. Dekani, brenda 3 ditësh pune nga dorëzimi i ankimit, i kërkon Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore ‘Doktor’ të marrë në shqyrtim vlerësimin dhe procedurën e ndjekur nga Komisioni i Pranimit. Komisioni i Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore ‘Doktor’, pasi konsultohet me Komisionin e Pranimit, brenda 6 ditësh pune nga depozitimi i ankimit nga ana e Dekanit në këtë komision (KPDHGD), vendos:
  - a) Rishqyrtimin e aplikimit të kandidatit për doktorant.
  - b) Lënien në fuqi të vlerësimit të Komisionit të Pranimit.

Vendimi i Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore ‘Doktor’ është i formës së prerë dhe i paapelueshëm.





2. Pas vendimit të Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, riorganizohet renditja e kandidatëve sipas pikëve të siguruara.
3. Në rastet kur Komisioni i Vlerësimeve të Pjesëshme merr vendime sipas përcaktimeve në Neni 7, Pika 6, doktoranti ka të drejtë, që brenda 2 ditësh nga vlerësimi, ti drejtohet me shkresë Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës “Doktor” i cili pasi kërkon sqarime nga Komisioni i Vlerësimeve të Pjesëshme, Udhëheqësi Shkencor dhe doktoranti jep vendimin e tij i cili është i paapelueshëm.
4. Në rastet kur komisioni *ad hoc* i vlerësimit të temës së doktoraturës jep vlerësim negativ, doktoranti, brenda 2 ditësh, mund ti drejtohet Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës “Doktor” me shkresë për të apeluar vendimin. Komisioni i Përhershëm për dhënien e Gradës “Doktor” pasi ka vlerësuar procedurën e ndjekur dhe, sipas rastit, ka marrë sqarimet e nevojshme nga komisioni *ad hoc*, brenda 5 ditësh, mund të vendosë aprovimin e vendimit të komisionit ose rivlerësimin e temës së doktoratës. Në rastet kur dekani vendos rivlerësimin e temës së doktoraturës, komisioni *ad hoc* i vlerësimit të temës duhet të ndryshohet me 2/3 e anëtarëve të tij.
5. Doktoranti ka të drejtën e apelimit të vendimit të Jurisë. Me këtë rast, ai mund ti drejtohet me shkresë Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, jo më vonë se 10 ditë nga data e mbrojtjes së Temës së Doktoratës. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, pas marrjes së kërkesës së ankimimit, thërret në një seancë shqyrtimi Jurinë dhe Udhëheqësin Shkencor të Doktorantit. Pas kësaj seance, Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” shpall gjykimin e tij, i cili është i paapelueshëm. Thirrja e seancës shqyrtuese dhe marrja e vendimit nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së ankimimit.

## Kreu VI

### Të Drejtat dhe Detyrimet e Kandidatëve për Gradën Doktor

#### Neni 34

##### Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të Doktorantit

1. Kandidati për gradën shkencore “Doktor”, fiton statusin e Doktorantit porsa regjistrohet në programin e studimeve të doktoraturës pranë Fakultetit që ofron këtë program studimi.
2. Statusi i doktorantit humbet mbas mbrojtjes së Temës së Dizertacionit, gjatë periudhës së pezullimit të studimeve dhe në momentin kur kandidati çregjistrohet nga studimet e doktoraturës.

#### Neni 35

##### Të drejtat e Doktorantit dhe detyrimet e tij







Të drejtat dhe detyrimet e kandidatit për të fituar gradën shkencore “Doktor” paraqiten të hollësishme në Rregulloren e programit që ofrohet në Fakultetin e UART.

**Neni 36**  
**Sigurimi i Cilësisë**

1. Programi i studimit të doktoraturës i nënshtrohet vlerësimit periodik të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.
2. Përgjegjësia e sigurimit të cilësisë së programit të studimit të doktoraturës i takon Komisionit të përhershëm për dhënie të Gradës shkencore “Doktor”, Udhëheqësit Shkencor, Bashkudhëheqësit, nëse ka, dhe vetë doktorantit.

**KREU VII**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 37**

1. Çdo ndryshim i kësaj Rregullore miratohet nga Senati Akademik.
2. Universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e kësaj rregulloreje.
3. Rregullorja e ciklit të tretë të studimeve për fitimin e Gradës shkencore “Doktor” hyn në fuqi pas miratimit të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve.

